



ACA Margjeka shpk

Adresa: Rruga Tre Vellezerit Kondi, Nderresa nr.736,
Cel. +355 66 207 0654, shkelzenmargjeka@yahoo.com,
NIPT-i L 61408003 D, Tirane, Albania

Auditues Ligjor Halim Bakalli

Adresa: Rruga * Don Bosco*, Pallati *AK*, Shk.1, Kati 4, Ap.15
Mobil: +355 69 20 79 263, Email: halimbakalli@yahoo.com.
NIPT-i L 64708201 O, Tirane, Albania.

RAPORTI I AUDITUESIT LIGJOR

Per Aksionarin e Vetem.

Te Entitetit *Partizani*sha

Adresa : Rruga "Asim Vokshi", pallat 13 katesh, K.2, prane Arkives Qendrore, Tirane.

Opinion

- ⊗ Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur, të shoqërisë ***PARTIZANI*** sha ,të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datë 31 Dhjetor 2020 ,pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e fluksit të parasë për ushtrimin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare ,përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.
- ⊗ Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin pamjen e vertetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Shoqërisë me datë 31 Dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të vendit tonë që janë ne fuqi.

Baza për Opinionin

- ⊗ Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standarteve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e Pasqyrave Financiare në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.





ACA Margjeka shpk

Adresa:Rruga Tre Vellezerit Kondi,Ndertesa nr.736,
Cel.+355 66 207 0654,shkelzenmargjeka@yahoo.com,
NIPT-i L 61408003 D, Tirane,Albania

Auditues Ligjor Halim Bakalli

Adresa:Rruga * Don Bosco*,Pallati *AK*,Shk.1,Kati 4,Ap.15
Mobil: +355 69 20 79 263, Email:halimbakalli@yahoo.com.
NIPT-i L 64708201 O ,Tirane ,Albania.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në Lidhje me Pasqyrat Financiare

- ① Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Kombetare të Kontabilitetit,dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale,qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.
- ② Në përgatitjen e pasqyrave financiare,drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vashduar në vijëmesi,duke dhënë informacion,nëse është e zbatueshme,për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabel të vijimësisë përveç se ne rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet,ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

- ① Objektivet tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale,për shkak të mashtrimit apo gabimit,dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë.Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë ,por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas Standarteve Nderkombetare të Auditimit do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalite mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsideron materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku,pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve,të marra bazuar në këto pasqyra financiare. Një përshkrim më i detajuar i përgjegjësive të audituesit për auditimin e pasqyrave financiare mund të gjendet në faqen e internetit të Institutit të Eksperteve Kontabel të Autorizuar në:www.ieka.al . Ky përshkrim përbën pjesë të raportit tonë të auditimit.

Audituesit Ligjor

Halim BAKALLI



Shkelzen Margjeka



Tirane, me 25 Mars 2021.

